

V E N D I M
Nr. 602, datë 4.12.2002

**PËR MIRATIMIN E LEJES SË FUNKSIONIMIT TË INSTITUCIONIT ARSIMOR,
JOPUBLIK, MEDRESEJA "HAFIZ ABDULLAJ ZËMBLAKU"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 44 të ligjit nr. 7952, datë 21.6.1995 "Për sistemin arsimor parauniversitar", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes së funksionimit të institucionit arsimor, jopublik, fetar, të nivelit të arsimit të mesëm, medreseja "Hafiz Abdullah Zëmbaku" në Korçë.

2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe e Shkencës për të përcaktuar modalitetet e funksionimit të këtij institucioni arsimor, jopublik, dhe për të ndjekur zbatimin e dispozitave, ligjore e nënligjore, për arsimimin, edukimin, formimin dhe kualifikimin në këtë institucion.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano